



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 40, datë 27.03.2019

PËR

**MIRATIMIN E AGJENTIT NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
SHOQËRISË “AMAL SHIPPING” SH.P.K.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 194, pika 4, të nenit 195, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Zyra e Licencimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Z. Genc Sharkaj për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë “AMAL SHIPPING” sh.p.k., subjekt i licencuar për të ushtruar veprimtari agjenti në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.
2. Ngarkohet Zyra e Licencimit/Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI